



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK - OPŠTINA JUNIK - MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02-180/02/24
Datë: 22.02.2024.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

FTESË

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Nga: Shpejtim Gacaferi - kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut;
Lënda: Mbledhja e dytë (02) - e rregullt 2024 të Legjislacionit V të Kuvendit të Komunës së Junikut;
Vendi: Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut;
Data: 29.02.2024, ora 10⁰⁰.



Rendi i ditës:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
3. Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023;
5. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit;
6. Të ndryshme.

KOMUNA JUNIK

RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Konform neni 87.2.12 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së raportit: 31.01.2024

Viti fiskal : 2023

PJESA I . IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	
Lloji i Autoritetit Kontraktues (zgjdhëne njëren)	Qeveritar
Kodi buxhetor	636
Adresa	Qender- Junik
Kodi postar - Qyteti	51050
Tel. fiks/ Celulari /Faksi	0390-370-616
Emri i menaxherit të prokurimit	Florinda Kukalaj
E-mail adresa	prokurimi-junik@rks-gov.net
Adresa e webit të AK	https://kk.rks-gov.net

PJESA II .KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Lloji i Buxhetit	Nr.i Prokurimit				Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (ne rast anulimit data e njoftimit për anulim)	Afati për implementimin e kontratës (shkruaj datën e fillimit dhe të përfundimit)	Data e përfundimit të kontratës (data e pranimit të përkohshëm/ preliminar)	Vlera e parashikuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Çmimi i Aneks kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat etj.	Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave	Çmimi total i paguar për kontratën	Emri i OE të cilit i është dhënë kontrata	OE vendor (1) ; Jo vendor (2)	Numri i kërkesave për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara	Numri i ofertave të realizuara (shëruaj vetëm ato me emrinin më të ulët në krahosim me fituesin)	Afati kohor për pranimin	Kriteret për dhënie kontratës		
	Të Hyra Vetanake (1) ose Bushi i Kosovës (2) ose Donacion (3)	Numri rendor i prokurimit	Lloji i prokurimit	Vlera e prokurimit																	Procedura e prokurimit		Klasifikimi (2 shifrat e para të FPP)	Afati kohor normal (1)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	
2+AA28179	636-23-607-1-3-6	1	3	6	2	Furnizim me dru për institucionet edukativo- arsimore të Komunës së Junikut	3.2.2023.	08.02.2023	03.03.2023	01.03.2023	01.03.2023	30.07.2023	9,750.00	7,540.00	n/a	n/a	7,540.00	N.T.P."GRESA - COMMERCE "	1	9	9	N/A	1	1
2	636-23-2473-2-3-6	2	3	6	66	Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve të zjarrëfiksave	21.03.2023	28.03.2023	21.04.2023	20.04.2023	20.04.2024	1,600.00	1,556.90	n/a	n/a	1,556.00	SIGMA INTERALBANIA N VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.-DEGA KOSOVË	1	1	1	N/A	1	1	
2	636-23-1739-5-2-1	5	2	1	45	Ndërtimi (rikonstruimi) i rrugës Bajraktar- Gaxherr	6.3.2023.	09.03.2023	28.04.2023	25.04.2023	25.4.2023	24.06.2023	140,000.00	137,395.00	n/a	n/a	137,395.00	Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; ETNOGROUP CO SH.P.K.; NIVA Construction ' SH.P.K.	1	2	2	1		
2	636-23-2437-1-3-6	1	3	6	93	Furnizim me mjete didaktike për IEA të Komunës së Junikut	21.03.2023	28.03.2023	01.05.2023	28.04.2023	28.04.2023	28.05.2023	1,795.00	1,580.00	n/a	n/a	1,580.00	BEHAR RAMA B.I.	1	2	2	N/A	1	1
2	636-23-2040-2-3-6	2	3	6	93	Sinjalizimi vertikal dhe horizontal në Komunën e Junikut	13.03.2023	16.03.2023	15.05.2023	11.05.2023	11.05.2023	31.12.2023	2,000.00	1,599.12	n/a	n/a	1,599.12	. Limit L & B SH.P.K.	1	2	2	N/A	1	1
2	636-23-3617-1-2-1	1	2	1	34	Blerja e automjetit për nevojat e Komunës së Junikut	27.03.2023	14.04.2023	17.05.2023	12.05.2023	12.05.2023	12.06.2023	20,000.00	19,790.00	n/a	n/a	19,790.00	" Auto Mita " SH.P.K.	1	1	1	N/A	2	1
2	636-23-2977-5-2-1	5	2	1	45	Ndërtimi i urës që lidh Komunën e Junikut me Eko fshatrat Gjocaj dhe Jasiq	29.03.2023	05.04.2023	24.05.2023	19.05.2023	19.05.2023	10.11.2023	122,174.50	121,319.00	n/a	n/a	89570	" V - SHEHU " SH.P.K.	1	2	2	1	2	1

2	636-23-5023-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me material zyrtar- foldera	18.05.2023	N/A	24.05.2023	19.05.2023	19.05.2023	19.06.2023	995.00	990.00	n/a	n/a	990	Hasan Is. Krasniqi	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-3624-1-3-6	1	3	6	30	Furnizim me pajise harduerike (te forta) te kompjuterëve	14.04.2023	14.04.2023	29.05.2023	25.05.2023	25.05.2023	15.12.2023	8,300.00	7,493.00	n/a	n/a	7,493.00	" INFINITT " SH.P.K.	1	4	4	1	1	1
2	636-23-2982-5-3-6	5	3	6	45	Hapja e rrugëve fushore Troje, Shafrane, Gjocaj 1. Hapja e rrugës fushore Troje	24.03.2023	05.04.2023	29.05.2023	24.05.2023	24.05.2023	24.07.2023	10,000.00	9,645.00	n/a	n/a	9,645.00	JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.	1	3	3	1	1	1
2	636-23-4056-2-2-1	2	2	1	50	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve dhe i gjeneratorëve	05.05.2023	05.05.2023	06.06.2023	02.06.2023	02.06.2023	02.06.2026	27,600.00	11604.9 Çmimi i poentuar	n/a	n/a	8,294.60	"SEFERI-MONT" SH.P.K.	1	1	1	N/A	2	1
1	636-23-5240-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me buqeta lulesh për manifestime	22.05.2023	N/A	09.06.2023	06.06.2023	06.06.2023	30.04.2024	930.00	928.50	n/a	n/a	413.5	JETA EVENT SH.P.K.	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-5366-2-4-7	2	4	7	93	Vendosja e pllakës për emërtimin e QKMF- së, Junik	10.06.2023	N/A	12.06.2023	09.06.2023	09.06.2023	10.07.2023	995.00	969.50	n/a	n/a	969.5	Samir Zajmi	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-3232-1-2-1	1	2	1	24	Furnizime mjekësore për QKMF- Junik	27.03.2023	10.04.2023	22.06.2023	22.06.2023	22.06.2023	22.06.2024	12,000.00	10,639.63	n/a	n/a	5,089.49	MATKOS PHARM SH .P.K.	1	2	1	N/A	1	1
2	636-23-2969-2-2-1	2	2	1	93	Rehabilitimi i rrugëve lokale	21.03.2023	05.04.2023	03.07.2023	27.06.2023	27.06.2023	27.06.2026	55,000.00	53,090.00	n/a	n/a	15,000.00	JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.	1	3	3	1	1	1
2	636-23-3452-5-2-1	5	2	1	45	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes (Topilla- Gaxherr)	24.03.2023	17.04.2023	04.07.2023	26.06.2023	26.06.2023	31.12.2023	20,000.00	19,860.00	n/a	n/a	19860	" V - SHEHU " SH.P.K.	1	2	2	N/A	2	1
2	636-23-4065-2-2-1	2	2	1	93	Mirëmbajtja e kamerave të sigurisë në Komunën e Junikut	25.04.2023	08.05.2023	24.07.2023	13.07.2023	13.07.2023	02.11.2023	10,594.00	7,029.50	n/a	n/a	0	N.T.SH . NODE TECH	1	4	4	N/A	1	1
2	636-23-5864-5-2-1	5	2	1	45	Ndërtimi kanalizimit sekondar për ujërat e zeza lokacioni Bajraktar, 7 Shtator dhe Qendër (Rregullimi kanalizimit të lagjes Gaxherr, Miroc dhe Qender)	01.06.2023	12.06.2023	31.07.2023	17.07.2023	17.07.2023	14.10.2023	50,000.00	43,375.00	n/a	n/a	38,371.00	" V - SHEHU " SH.P.K.	1	2	2	N/A	1	1
2	636-23-7912-2-4-7	2	4	7	93	Zërimi, bina dhe ndriçimi për koncertin e bashkëatdhetarëve	27.07.2023	N/A	31.07.2023	28.07.2023	28.07.2023	25.08.2023	900.00	899.00	n/a	n/a	899	N.T.SH. " TONI "	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-7916-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me ushqime tradicionale (Dita e Kullave dhe Dita e Plisit)	27.07.2023	N/A	31.07.2023	28.07.2023	28.07.2023	25.08.2023	990.00	990.00	n/a	n/a	990	SHOQATA E GRUAS QËRSHIZA JUNIK	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-8052-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me banera për mikëpritjen e bashkëatdhetarëve	31.08.2023	N/A	03.08.2023	01.08.2023	01.08.2023	01.09.2023	950.00	950.00	n/a	n/a	950	SELMANS NETWORK SH.P.K.	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-5844-5-2-1	5	2	1	45	Kanalizimi i ujërave të zeza, Lokacioni Moronicë dhe lagjia Krasniq	01.06.2023	12.06.2023	04.08.2023	01.08.2023	01.08.2023	30.06.2024	71,290.00	64,326.00	n/a	n/a	55,000.00	Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; NIVA Construction ' SH.P.K.	1	2	2	N/A	2	1
2	636-23-4071-5-3-6	5	3	6	45	Ndërtimi i rrethojës dhe rregullimi i oborrit në QPS dhe QKMF- Junik	19.04.2023	05.06.2023	04.08.2023	03.08.2023	03.08.2023	03.11.2023	9,990.00	9,227.00	n/a	n/a	9,227.00	GO ING SH.P.K.	1	5	5	1	1	1
2	636-23-5975-2-2-1	2	2	1	60	Transporti i nxënësve Ritender	24.03.2023	13.06.2023	23.08.2023	21.08.2023	21.08.2023	21.08.2024	16,280.00	16,169.00	n/a	n/a	5,332.00	N.T.,Juniku Reisen"	1	1	1	N/A	2	1
2	636-23-8882-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me ditare dhe arkivë për lëndë (Dosje për folderë)	22.08.2023	N/A	28.08.2023	23.08.2023	23.08.2023	08.09.2023	850.00	845.00	n/a	n/a	845	N.T. "Agimi- De"	1	3	1	N/A	1	1

2	636-23-6227-2-3-6	2	3	6	93	Kontrolja, servisi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit	26.04.2023	19.06.2023	31.08.2023	28.08.2023	28.08.2023	28.08.2024	1,954.00	1,304.00	n/a	n/a	574	Murat Abazi B.I.	1	2	2	1		1	1
2	636-23-6860-2-3-6	2	3	6	93	Lyerja mbrenda objektit shkollor të gjimnazit Kuvendi i Junikut	21.06.2023	10.07.2023	04.09.2023	31.08.2023	31.08.2023	30.09.2023	4,500.00	4,168.30	n/a	n/a	4,168.30	Ermal Dinaj B.I.	1	2	2	1		1	1
2	636-23-6474-5-2-1	5	2	1	45	Ndërtimi i mureve mbrojtëse, lokacioni Tofaj dhe Pesh	15.06.2023	28.06.2023	11.09.2023	01.09.2023	01.09.2023	01.11.2023	20,000.00	18,019.75	n/a	n/a	18,019.75	"V - SHEHU" SH.P.K.	1	2	2	N/A		2	1
2	636-23-9259-2-4-7	2	4	7	93	Dokumentar për poetin Din Mehmeti	30.08.2023	N/A	13.09.2023	07.09.2023	07.09.2023	07.10.2023	900.00	900.00	n/a	n/a	900	Islam Haxhiu B.I.	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-7653-2-1-1	2	1	1	93	Shërbimet e kujdesit social, shëndetësor, shtëpiak dhe ambulatorë në QKMF- Junik		27.07.2023	27.09.2023	21.09.2023	21.09.2023	21.09.2026	150,000.00	1.23 Çmimi i poentuar	n/a	n/a	6,874.00	KosovaMed Healthcare SH.P.K.	1	1	1	N/A		2	1
2	636-23-10937-2-4-7	2	4	7	93	Pastrimi i objektit të Vajavicës dhe kullës Qendra Rajonale për Turizëm QRT n' Dukagjin	5.10.2023	N/A	16.10.2023	11.10.2023	11.10.2023	11.11.2023	980.00	980.00	n/a	n/a	980	FT CONECTION SH.P.K.	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-9875-2-2-1	2	2	1	93	Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe menaxhimi me mbeturina	17.08.2023	29.09.2023	16.10.2023	13.10.2023	13.10.2023	13.10.2025	37,200.00	30,672.00	n/a	n/a	2,179.00	Euro - Steel SH.P.K.	1	1	1	N/A		2	1
2	636-23-11389-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me ushqime tradicionale	18.10.2023	N/A	20.10.2023	19.10.2023	19.10.2023	19.11.2023	995.00	990.00	n/a	n/a	990	SHOQATA E GRUAS QËRSHIZA JUNIK	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-11387-2-4-7	2	4	7	93	Akomodim për delegacionin nga Komuna Gjermane Nuthe-Urstromtal	17.10.2023	N/A	23.10.2023	20.10.2023	20.10.2023	20.11.2023	990.00	990.00	n/a	n/a	990	HOTEL SÉRAPHINA SH.P.K.	1	3	2	N/A		1	1
2	636-23-9261-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me raftë për uniformat e zjarrefiksive të Komunës së Junikut	22.10.2023	N/A	25.10.2023	23.10.2023	23.10.2023	23.11.2023	990.00	950.00	n/a	n/a	950	Bashkim Nika B.I.	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-11907-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me veshëmbathje (uniforma) për QKMF dhe QPS- Junik	29.10.2023	N/A	31.10.2023	30.10.2023	30.10.2023	30.11.2023	999.00	996.00	n/a	n/a	996	"PUNTEX" SH.P.K.	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-6877-1-2-1	1	2	1	2	Furnizim me lëndë djegëse me pelet për shkolla	21.06.2023	22.08.2023	01.11.2023	30.10.2023	30.10.2023	29.12.2023	22,000.00	16,740.00	n/a	n/a	16,740.00	Grup i Operatorëve Ekonomik Gëzime S. Gashi B.I.; N.P.T. Meti Comerc	1	5	5	N/A		1	1
2	636-23-9602-2-3-6	2	3	6	93	Servisi i paisjeve mjekësore, laboratorike dhe të stomatologjisë-QKMF	08.09.2023	11.09.2023	06.11.2023	31.10.2023	31.10.2023	31.10.2024	2,450.00	2,450.00	n/a	n/a	2,025.00	PRO MEDICAL SH.P.K.	1	1	1	N/A		1	1
2	636-23-11969-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me paisje sportive	30.10.2023	N/A	06.11.2023	01.11.2023	01.11.2023	01.12.2023	990.00	968.00	n/a	n/a	968	Fatmir Godeni B.I.	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-11864-2-4-7	2	4	7	93	Krijimi i webfaqes (website) për promovimin e turizmit në Komunën e Junikut	14.11.2023	N/A	16.11.2023	15.11.2023	15.11.2023	15.12.2023	970.00	970.00	n/a	n/a	970	Samir Zajmi	1	3	1	N/A		1	1
2	636-23-10842-5-3-6	5	3	6	45	Rregullimi i hapësirave sportive, rekreative dhe të ambientit në shkollën fillore Edmond Hoxha	21.07.2023	09.10.2023	17.11.2023	07.11.2023	07.11.2023	15.04.2024	9,997.00	9,050.00	n/a	n/a	5,000.00	7 ING O.P.	1	2	2	N/A		1	1

2	636-23-12907-2-4-7	2	4	7	93	Ndarje e parcelave	31.10.2023	N/A	21.11.2023	20.11.2023	20.11.2023	20.12.2023	720.00	720.00	n/a	n/a	720	GEO-3D STUDIO SH.P.K.	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-12711-2-4-7	2	4	7	93	Vendosja e trupave ndriçues të ndriçimit publik në territorin e Komunës së Junikut	14.11.2023	N/A	21.11.2023	20.11.2023	20.11.2023	20.12.2023	975.00	875.00	n/a	n/a	875	LEMKOS SH.P.K.	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-10465-1-3-6	1	3	6	30	Furnizim me pajisje teknologjike për gjimnazin Kuvendi i Junikut	24.03.2023	29.09.2023	27.11.2023	23.11.2023	23.11.2023	23.12.2023	7,000.00	3,177.00	n/a	n/a	3,177.00	TRIO TECH SH.P.K.	1	5	5	N/A	1	1
2	636-23-10465-1-3-6	1	3	6	30	Furnizim me pajisje të teknologjisë informatike për administratën komunale	28.09.2023	29.09.2023	27.11.2023	23.11.2023	23.11.2023	23.12.2023	2,500.00	3,225.00	n/a	n/a	3,225.00	TRIO TECH SH.P.K.	1	5	5	N/A	1	1
2	636-23-11875-5-3-6	5	3	6	45	Hapja dhe rregullimi i rrugës në fshatin Gjocaj		30.10.2023	28.11.2023	27.11.2023	27.11.2023	27.12.2024	10,000.00	8,888.50	n/a	n/a	8888.5	Q SHALA SH.P.K.	1	2	2	N/A	1	1
2	636-23-10293-1-3-6	1	3	6	93	Furnizim me pajisje për analiza laboratorike në QKMF në Junik		09.10.2023	30.11.2023	27.11.2023	27.11.2023	27.12.2023	5,000.00	4,000.00	n/a	n/a	4,000.00	"BIOTEK KOSOVO " L.L.C.	1	1	1	N/A	1	1
2	636-23-11837-5-3-5	5	3	5	45	Ndërtimi (rikonstruimi) i rrugës Bajraktar- Gaxherr		N/A	11.12.2023	06.12.2023	06.12.2023	06.01.2024	6,044.25	6,044.25	n/a	n/a	6,044.25	Grup i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; ETNOGROUP CO SH.P.K.; NIVA Construction ' SH.P.K.	1	1	1	N/A	1	1
2	636-23-13693-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me pajisje për pastrim për IEA	23.11.2023	N/A	08.12.2023	07.12.2023	07.12.2023	07.01.2024	998.00	997.00	n/a	n/a	997	N.T.SH. " GIPA "	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-13740-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me kamera për shkollën fillore Edmond Hoxha	24.11.2023	N/A	12.12.2023	08.11.2023	08.11.2023	08.12.2023	999.00	996.00	n/a	n/a	996	Abedin H. Krasniqi	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-12715-2-3-6	2	3	6	93	Dekorimi i qytetës së Junikut për festat e fundvitit 2023		16.11.2023	18.12.2023	14.12.2023	14.12.2023	14.01.2024	2,995.00	4,990.00	n/a	n/a	4,990.00	Adhurim Haraqia B.I.	1	2	2	1	1	1
2	636-23-12719-2-3-6	2	3	6	93	Mirëmbajtja e urave për këmbësorë dhe shtyllave të ndriçimit	14.11.2023	23.11.2023	18.12.2023	14.12.2023	14.12.2023	14.01.2024	4,598.00	4,096.00	n/a	n/a	4,096.00	Metal Ing SH.P.K.	1	3	3	N/A	1	1
2	636-23-13949-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me material shpenzues për mirëmbajtje	04.12.2023	N/A	19.12.2023	14.12.2023	14.12.2023	14.01.2024	994.00	992.70	n/a	n/a	992.7	" HIDRO BAU " SH.P.K.	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-13697-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me gjenerator për gjimnazin Kuvendi i Junikut	24.11.2023	N/A	22.12.2023	20.12.2023	20.12.2023	20.01.2024	999.00	950.00	n/a	n/a	950	D.P.T. "Honda KS"	1	3	1	N/A	1	1
2	636-23-13959-1-4-7	1	4	7	93	Furnizim me material administrativ me logo të Komunës	04.12.2023	N/A	22.12.2023	20.12.2023	20.12.2023	20.01.2024	995.00	995.00	n/a	n/a	995	Samir Zajmi	1	3	1	N/A	1	1

2	636-23-13960-1-4-7	1	4	7	93	Veshje tradicionale për Ansamblin e Komunës së Junikut	08.12.2023	N/A	22.12.2023	20.12.2023	20.12.2023	20.01.2024	950.00	950.00	n/a	n/a	950	ARDI HASANMETAJ B.I.	1	3	1	N/A	1	1			
2	636-23-12712-2-3-6	2	3	6	93	Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit publik	15.11.2023	15.11.2023	22.12.2023	21.12.2023	21.12.2023	21.12.2024	7,480.00	6,680.00	n/a	n/a	5,000.00	TONI INGINJERING	1	4	4	N/A	1	1			
2	636-23-12920-5-3-5	5	3	5	45	Ndërtimi i mureve mbrojtëse, lokacioni Tofaj dhe Peps	14.09.2023	N/A	25.12.2023	13.12.2023	13.12.2023	13.01.2024	1,798.00	1,798.00	n/a	n/a	1,798.00	"V - SHEHU" SH.P.K.	1	1	1	N/A	1	1			
2	636-23-11695-1-3-6	1	3	6	93	Furnizim me material higjienik	24.10.2023	24.10.2023	25.12.2023	21.12.2023	21.12.2023	21.12.2025	8,580.00	5,353.00	n/a	n/a	2,353.00	Shaip Mustafa B.I.	1	7	7	1	1	1			
2	636-23-12062-1-3-6	1	3	6	93	Furnizimi dhe montimi i klimave për QKMF në Junik	01.11.2023	01.11.2023	28.12.2023	26.12.2023	26.12.2023	26.01.2024	4,000.00	3,300.00	n/a	n/a	3,300.00	Adnani group SH.P.K.	1	7	7	1	1	1			
2	636-23-12897-2-3-6	2	3	6	93	Materiale informuese promovuese për zyrën e informimit turistik	16.11.2023	08.12.2023	28.12.2023	26.12.2023	26.12.2023	26.12.2024	8,690.00	7,900.00	n/a	n/a	2,499.20	Meriton Belegu B.I.	1	1	1	N/A	1	1			
													#####	€ 695,281.65	€ 0.00	€ 0.00	€ 558,569.91									1	1

TOTALI (15+16-17) : 695,281.65

Udhëzime për plotësimin e raportit :

Te kolona 1	Të hyrat vetanake = 1 (nëse burim i financimit të projektit janë të hyrat vetanake , shënoni nr. 1 (E plotësojn vetëm Kompanit Publike)
	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës = 2 (nëse burim i financimit të projektit është nga granti qeveritar , shënoni nr. 2)
	Donacion = 3 (nëse burim i financimit të projektit është nga donatorët , shënoni nr. 3)
	Nëse projekti financohet nga dy apo tri burime, shëno çdo burim në rresht të veçantë, pra duke i përsëritur të gjitha shënimet.
Te kolona 2	(Numri rendor i prokurimit) shënohet numri i radhës së prokurimit (i cili fillon për çdo vit fiskal prej 001). Nëse Kontrata ka qenë në Pjesë, dhe i është dhënë më tepër se një OE, atëherë shëno çdo kontratë në rresht të veçantë.
Te kolona 3	Lloji i prokurimit (shënohet vetëm një kod që paraqet llojin e prokurimit. Kodet janë këto:)

- k o d** Llojet e prokurimit
- 1** Furnizim
- 2** Shërbime
- 3** Shërbime Këshillimi
- 4** Konkurs projektimi
- 5** Punë
- 6** Punë me koncesion
- 7** Pronë e paluajtshme

Te kolona 4	Vlera e prokurimit (shënohet vetëm një kod që paraqet vlerën e llogarit të aktivitetit të prokurimit. Kodet janë këto:)
k o d	Vlera e prokurimit
1	Vlerë e madhe
2	Vlerë e mesme
3	Vlerë e vogël
4	Vlerë minimale

Te kolona 5	Procedura e prokurimit (shënohet vetëm një kod që paraqet procedurën e përdorur. Kodet janë këto:)
k o d	Procedura e prokurimit
1	Procedura e hapur
2	Procedura e kufizuar
3	Konkurs projektimi
4	Procedura e negociuar pas publikimit të njoftimit të kontratës
5	Procedura e negociuar pa publikimit të njoftimit të kontratës
6	Procedura e kuotimit të Çmimeve

7	Procedura e vlerës minimale
Te kolona 6	FPP (shënohen dy shifrat e para të Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit)
Te kolona 7	Titulli i aktivitetit të prokurimit (shënohet titulli që ia keni dhënë aktivitetit të prokurimit)
Te kolona 8	Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit (shënohet data e nënshkrimit të Deklaratës së Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve - DNVDF)
Te kolona 9	Data e publikimit të njoftimit për kontratë (shënohet data e publikimit të njoftimit për kontratë në web-faqen e KRPP-se)
Te kolona 10	Data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës (shënohet data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës në web-faqen e KRPP-se)
Te kolona 11	Data e nënshkrimit të kontratës (shënohet data kur kontrata është nënshkruar nga palët kontraktuese si dhe në rast anulimi data kur bëhet publikimi i anulimit në web-faqen e KRPP-se)
Te kolona 12	Afatet për implementimin e kontratës (shënohet data e parapare e fillimit dhe e përfundimit të implementimit të kontratës - kohëzgjatjes së kontratës)
Te kolona 13	Data e përmbylljes së kontratës (shënohet data e pranimit të përkohshëm të mallrave/shërbimeve/punëve, data e raportit të pranimit)
Te kolona 14	Vlera e parashikuar e kontratës (shënohet vlera e parashikuar e kontratës (jo çmimi për njësi, por vlera totale e parashikuar dhe vendosur në DNVDF), sipas LPP-së)
Te kolona 15	Çmimi i kontratës (shënohet vlera e kontratës së nënshkruar duke përfshirë të gjitha taksat eij (jo çmimi për njësi, por vlera totale e përlogaritur)
Te kolona 16	Çmimi i Aneks kontratës , (shënohet vlera e Aneks kontratës duke përfshirë të gjitha taksat eij, nese ka aneks kontrate).
Te kolona 17	Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave (shënohen zbritjet/ndalesat e përlogaritura në rast të aktivizimit të penaleve)
Te kolona 18	Çmimi total i paguar për kontratën (shënohet vlera përfundimtare e paguar e kontratës)
Te kolona 19	Emri i OE (shënohet vetëm emri i Operatorit Ekonomik të cilit i është dhënë kontrata)
Te kolona 20	OE Vendor = 1; OE Jo vendor = 2; (nëse kontrata i është dhënë OE vendor shënoni numrin 1 , për OE jo vendor shënoni numrin 2)
	<i>Nëse projekti iu është dhënë dy OE, shënoje pjesën e kontratës se OE vendor në një rresht dhe pjesën e kontratës OE jo vendor në rreshtin tjetër</i>
Te kolona 21	Numri i kërkesave për DT dhe numri i ofertave të dorëzuara (shënohet numri i kërkesave për marrjen e Dosjes së Tenderit-DT dhe numri i ofertave të dorëzuara)
Te kolona 22	Numri i ofertave të refuzuara (shënohet vetëm numri i ofertave me çmimin më të ulët të refuzuara në krahasim me fituesin)
Te kolona 23	Afati kohor normal = 1; Afati kohor i shkurtuar = 2; (nëse afati kohor ka qenë normal shënoni numrin 1 , nëse i shkurtuar shënoni numrin 2)
Te kolona 24	Çmimi më i ulët = 1; Tenderi ekonomikisht më i favorshëm = 2; (nëse kriteri ka qenë çmimi më i ulët shënoni numrin 1 , nëse kriteri ka qenë tenderi ekonomikisht më i favorshëm shënoni numrin 2)
Vërejtje: Raporti duhet të përfshijë të gjitha llojet e kontratave me vlerë të madhe, të mesme, të vogël dhe minimale.	



REPubLIKA E KOSOVËS
REPubLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK



REFERENC-Ë:	Numër: 01-02/24
PËR/ZA/TO:	Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik
NGA/OD/FROM	Shpejtim Gacaferi - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik
DATË/A	31.01.2024
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Procesverbal

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

PROCESVERBAL

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së parë (1) të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.01.2024, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Shpejtim Gacaferi: i cili në fillim përshëndeti, Kryetarin e komunës së Junikut z.Ruzhdi Shehu, nenkryetarin z. Tofaj, drejtorët e drejtorive komunale, anëtarët të Kuvendit Komunal, zyrtarët Komunal dhe gjithë të pranishmit me pas konstatoi se ne mbledhje marin pjese 14 antar te kuvendit. Në mbledhje nga drejtoret prezent ishin: znj.Leunora Shehu-AD, znj.Gentiana Tofaj-DEZH, z.Xhavit Velijaj DAKRS, z.Fatos Shala-DSHMS dhe z.Zenun Shala DUKM.

Anëtarët prezent

- | | |
|---|---|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpejtim Gacaferi - Kryesues, LDK 2. Sadri Krasniqi – Anëtar, LDK 3. Alfred Gaxherri - Anëtar, LDK 4. Mursel Salihaj-Anëtar,LDK 5. Ermelinda Lllolluni - Anëtare, LDK 6. Lirjeta Shehu - Anëtare, LDK 7. Leonard Lllolluni - Anëtar, AAK 8. Zenel Maloku - Anëtar, AAK 9. Dervish Bajraktari - Anëtar, AAK | <ol style="list-style-type: none"> 10. Rajmonda Krasniqi - Anëtare, AAK 11. Erleta Qestaj - Anëtare, AAK 12. Festina Maloku - Anëtare, AAK 13. Lulzim Gacaferi- Anëtar, LVV 14. Eliza Pepshi-Anëtare,LVV 15. Xhemë Tofaj-Anëtar LVV |
|---|---|

Me pas kryesuesi i Kuvendit te Komunes se Junikut kerkeoj nje minut heshtje me rastin e 27 vjetorit te renjes se Heronjeve te kombit, z.Edmond Hoxha, z.Zahir Pajaziti dhe z.Hakif Zejnullahu, LAVDI

Rendi i ditës i paraparë

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i Raportit finaciar për periudhen, Janar-Dhjetor 2023,
4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023,
6. Raporti i punë së KKSBB_së per vitin 2023,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Intergritetit për Komunën e Junikut për vitin 2024-2026,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i draft statusit te Strategjise Kunder Dhunes ne Familje per vitin 2024-2027
9. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit ,
10. Të ndryshme.

Meqe nuk pat asnje kerkese tjeter rendi i dites u miratua me 14 vota pro, 0 vota kunder dhe 0 vota abstenim

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,

z.Shpejtim Gacaferi, ne mbledhje sot mungon vetem z.Zenel Maloku.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

z.Shpejtim Gacaferi, meqe kerkese nuk ka, e qes ne votim procesverbalin e mbledhjes se kaluar, kush eshte per, per 14 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se procesverbali i mbledhjes se kaluar u miratua.

3. Shqyrtimi i Raportit finaciar për periudhen, Janar-Dhjetor 2023,

Prezentimin dhe arsyetimin e Raportit Finaciar e beri znj.Vjollca Qestaj drejtoresh ne DBF, e cila fillimisht i per shendeti te gjithë e me pas e prezentoï dhe e arsyetoï para anatrve te kuvendit Raportin Finaciar per periudhen Janar-Dhjetor 2023.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje per te gjithë, qeshtja ka te bej me shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, ne administrate i keni 3963€ te zhvillimi ekonomik 764€, te shërbimet publike i keni 156€, këtu nuk po shihent pastër kjo shume, ndërsa te drejtoria per financa keni 392€ dhe ne urbanizëm keni 2535€ gjithsej janë 7824€, a kishi mundur qe te na e laburoni pake kete qeshtje.

znj.Vjollca Qestaj, siq e dini ju si kuvendi, por edhe qytetaret e komunës se Junikut, komuna e Junikut ka nënshkruar marrëveshje binjakëzimi me disa komuna jashtë Kosoves, dhe kryetari bashke me disa antare te kabinetit te ti ka vizituar njëren nga këto komuna qe kemi nënshkruar binjakëzimin, gjithashtu kryetari ka bere disa vizita edhe ne SHBA, dhe Kanade, dhe keto udhëtime janë te prezentuara ne kete raport.

z.Leonard Lolluni, përshëndetje per te gjithë, e kam potencuar disa sa here edhe me pare per nje komune te vogël si qeshte Komuna e Junikut, dreka zyrtare 8065€, janë shpenzime enorme te larta, po ashtu kemi shpenzime te telefonit ne vlere 5000€ po ashtu shpenzime te larta, shpenzime per avokature 9087€ edhe kjo eshte shpenzim i larte sipas meje, dhe te shpenzimet tjera kontraktuse 7315€ qe nuk po dihet se ka përmban kjo kategori e shpenzimeve.

znj.Vjollca Qestaj, sa i perkete drekave zyrtare edhe me pare ne raporte tjera te me hershme ju kam prezentu se behet fjale per disa aktivitete qe ne si Komune i kemi mbajtur gjate viti 2023, siq janë “Ditete e Gjeravices”, “Dita e Geshtenjes”, nje turnir sportv ne kuadër te drejtoris se arsimit qe eshte mbajte dhe me duhet te cekim se e gjithë ky shpenzim per dreka zyrtare eshte mbrenda planifikimit qe kemi prezentuar per miratim këtu ne kete kuvend, te telefonia mobile, ne si komune kemi nje kontrate me operatorin Vala, per dalim me operatorin e me hershem qe ne oferte janë perfshire vetëm stafi udhëheqës, me operatorin Vala janë te perfshire ne kontrate te gjithë edhe stafi udhëheqës por edhe te gjithë zytratet komunal, përpos atyre qe nuk kane shprehur deshire te marin nje ofert, shpenzimet e avokaturës, komuna ka nje avokate me rroge mujore ne vlere prej 699€ dhe janë te prezentuar ne raport këto shpenzime, ndërsa sa i perkete kategoris shpenzime tjera kontraktuse, ne si komune kemi kode te ndryshme te shpenzimeve dhe ne kete kode i kemi disa lloje te shpenzimeve, dhe ne kete kode i kemi futur shpenzimet per zyre, ku eshte bere furnizimi per administratën komunale, per shendesit dhe per arsime, janë shpenzimet e printimit, per noter, mirëmbajtja e hapsirave publike, por mbi te gjitha edhe këto shpenzime janë mbrenda planifikimit.

z.Leonard Lolluni, drejtoresha tha se sa i perkete drekave zyrtare kemi mbajtur aktivitete tradicionale, dhe po dua te theksoj se edhe ne i kemi mbajtur këto aktivitete me herët dhe shpenzimet per dreka zyrtare per këto aktivitete i kemi mare si donacione, ekzistojnë raportet qe vertetojn kete, dhe une kisha shtuar këtu qe drejtoria qe inicion ate projekt te propozoi qe te mere donacion, sa i perkete shërbimeve tjera kontraktuse tezhvillimi ekonomik nje shpenzim ne vlere 3833€, drejtoresha e zhvillimit ekonomik e ka përmendur kete shpenzim edhe me here dhe tash po na del i dyfisht, ose na shpjegoni se çka ka ndodhur me kete shume prej 3833€.

znj.Vjollca Qestaj, une nuk mundem me dhan shqarim përpos drejtorisi qe e ka iniciuar ate shpenzim sepse mua me eshte dhene vetëm si vler e per aktivitet se si eshte shpenzuar sqarim se si janë shpenzuar parate japë drejtoria inicuse.

z.Sadri Krasniqi, përshëndetje per te gjithë, sa i perkete raporti financiar per vitin 2023, une se pari ju përgëzoj per prezentimin e keti raporti, por po ashtu ne pergjithesi per punen qe keni bere ne vitin 2023 nga kryetari i komunës e deri tek drejtoret, per shume arsye, sepse ne kete raport shihet se ka rritje te buxhetit dhe te hyrave vetanake, por shihet se ka rritje edhe te shpenzimeve edhe per kundër pengesave qe janë te cekura ne kete raport, ne si grupi i LDK_se e përkrahim

dhe e pershendesim kete raport financiar per vitin 2023, por gjithmonë me nje qellim qe raporti i viti 2024 te jete edhe me i suksesshem.

z.Lulzim Gacaferi, per zburimin e qendres per festat e fundviti dhe vitin e ri e keni cekur nje shume prej 4000€, dhe ne kemi pare qe ka qene vetëm nje bredhë dhe disa qarkore me drita, a keni pare te arsyshme qe ta kontaktoni ndonjë kompani tjetër qe ta zburonte qendrën e qe do te kushtonete me se shumti 1500€, a eshte kontrate e re apo e keni te trashëguar kete kontarte nga pushteti i me hershem.

znj.Vjollca Qestaj, ky projekt i perkete drejtorishe shërbimeve publike, por çka mundem me potencuar eshte se ky operatore ka ardhur nga përzgjedhja e prokurimit dhe ju ka nenshtrura te gjitha ligjeve qe i ka prokurim, dhe tash me e vlersu a eshte e drejt apo e pa drejte une nuk mundem ta vlerësoj.

z.Lulzim Gacaferi, dëgjo ju e keni per obligimqë paran e taksapaguesve tanë ta ruani, dhe nëse nuk jeni ne gjendje te te sjellni operatore me te lire mundeni me na kontaktu neve dhe ne mundemi me ju ndihmu qe te ju sjellim kompani me te lira, per dreka zyrtare me shume qe eshte cekur prej zyrës kryetarit pajtona sepse kryetari duhet te shtroi dreka per persona qe sjellin përfitime per komune tone por çka nuk pajtona eshte per këto shume tjera prej drejtrive si te administratës dhe te drejtoris per zhvillim ekonomik, a mundeni te na sqaroni per këto dy fatura.

znj.Leonora Shehu, përshëndetje per te gjithë, fatura e administratës per dreka zyrtare eshte per organizimin e “Dita e Geshtenjes” dhe tjetra eshte per organizimin e 8 Mars_it.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje per te gjithë, se pari une dua ti falemnderoj te gjithë drejtret per menaxhim te mire dhe efikase te këtyre shpenzimeve, por po ashtu falemnderoj edhe kuvendin per përkrahjen e këtyre projekteve gjate planifikimit dhe ndarjes se këtyre mjeteve qe kemi bere, ne i kemi disa aktivitete tradicionale siq janë dita e gështenjes, ditët e Gjeravices, dita e kullave qe ne kuadër te kësaj ka aktivitete tjera si qeshte dita e plisit, dhe te gjitha këto shpenzime kane qene te planifikuar dhe ne nuk i kemi tejkualuar këto planifikime, por per ti mbuluar ter shpenzimet qe njera drejtori e ka inicar ate aktivitet mer mjete nga drejtoria tjetre, ndesa sa i perkete shpenzimeve te udhëtimit jashtë vendit, une kam qene ne SHBA, Kande, dhe me nje delegacion ne Gjermani, po ashtu kemi pritur disa delegacione te jashtme dhe këto shpenzime janë te arsyshme dhe ne kuadër te planifikimit, ndërsa sa i perkete opratorit te zburimit te qendrës ai operature ju ka nënshtruar ligjit te prokurimit dhe përzgjedhja eshte bere nga prokurimim dhe une e kuptova z.Lulzim Gacaferi qe dëshiron te na ndimoje ne kete qeshtje.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjetër nuk ka kalojmë ne piken e radhës se rendit te ditës.

4. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2023,

Raporti e prezentoj dhe e arsyetoi para antarve te kuvendit z.Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunes se Junikut.

z.Mursel Salihaj, përshëndetje për të gjithë, e falemnderoj kryetarin e komunës z.Ruzhdi Shehu për prezentimin e raportit të punës për vitin 2023, unë eka shikuar dhe lexuar këtë raport, dhe normal se ky raport është edhe rezultat i punës së bërë brenda viti 2023, raporti është paraqitur në mënyrë perfekte, dhe unë vetëm dua të ju pergezojë dhe të ju uroj që në të ardhmen të jeni edhe më të mirë.

5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2023,

Prezentim dhe arsyetimin e raportit të punës së Kuvendit për vitin 2023 e bëri z.Shpejtim Gacaferi, Kryesues i Kuvendit të Komunes së Junikut.

z.Sadri Krasniqi, meqë po bahen punë të mirë nuk po mundem të mos e them që edhe në kuvend janë bërë punë të mira, kështu që ju përgëzoj për këtë raport kryesues.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka dhe meqë kërkohet miratimi nga kuvendit e qes në votim këtë raport, prezent janë 9 antar të kuvendit kush është për, për 9 vota kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota konstatoi se raporti i punës së kuvendit për vitin 2023 u miratua.

6. Raporti i punës së KKSB_së për vitin 2023,

Prezentimin dhe arsyetimin e Raportit të punës së KKSB_së për vitin 2023 e bëri Nenkryetari i Komunes së Junikut z.Besart Tofaj, koordinator në KKSB, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë e më pas e prezantoi raportin e punës së KKSB_së para antareve të Kuvendit.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë nuk ka e qes në votim raportin e punës së KKSB_së për vitin 2023 prezent jemi 9 antar të kuvendit, kush është për, për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se Raporti i punës së KKSB_së për vitin 2023 u miratua.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Intergritetit për Komunën e Junikut për vitin 2024-2026,

Prezentimin dhe arsyetimin e Planit të Intergritetit për vitin 2024-2026 e bëri z.Rrustem Pepshi, kryesuesi i komisionit, i cili fillimisht i përshëndeti të gjithë dhe më pas sqaroi para antareve të kuvendit planin e intergritetit për komune të Junikut 2024-2026.

z.Shpejtim Gacaferi, kërkesë tjetër nuk ka, e qes në votim planin e intergritetit për komune të Junikut, prezent janë 9 antarët e kuvendit, kush është për, për 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se plani i intergritetit për komunën e Junikut për vitin 2024-2026 u miratua.

8. Shqyrtimi dhe miratimi i draft statusit të Strategjisë Kunder Dhunës në Familje për vitin 2024-2027

Prezentimin dhe sqarimin e draft strategjisë kundër dhunës në familje e bëri z.Ruzhdi Shehu, kryetar i Komunes së Junikut.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese nuk ka e qes ne votim draft startegjin kundër dhunës ne familje, prezent janë 9 antaret e kuvendit, kush eshte per, per 9 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoise draft strategjia kundër dhunës ne familje per vitin 2024-2027 u miratua.

9. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit

10. Te ndryshme.

z.Lulzim Gacaferi, une se pari kame kerkese nga drejtoresha e Administartes te merre masa kundër atyre qe po e pengojn procesin e mbajtjes se mbledhjes se kuvendit, po ashtu kame pyetje per drejtorin e arsimit, isha ne objektin e shkollës para dy ditve per nje shkakt te djalit time, dhe ajo qe me beri përshtypje negative eshte mos prezentja e psikologes dhe pas interesimit tim se pse nuk ka pashe se psikologja anashkalohet nuk thirret te jete prezen kur fëmijët nxensit kane nevoje qe edhe ajo te jete prezent dhe te mirët me shkaqet e problemit, po ashtu ne klasne e 8/2 nxemja nuk funksionon, po ashtu kam nje qeshtje qe lidhet me shendesin, isha ne QKMF dhe aty mësova se puntorev Kosova Medika nuk ju eshte bere pagesa e pagave per dy muaj, po ashtu ju përgëztoj per funksionalizimin e QKMF_se per 24 ore dhe uroje qe kjo te mos jete e perkoshme por e përhershëm, ju e dini se une ne kete kuvend shume here e kam ngritur zërin qe QKMF_ja te jete funksionale 24 ore andaj per kete ju përgëztoj.

znj.Rajmonda Krasniqi, përshëndetje per te githe, pyetje per drejtorin e arsimit, siq jeni ne dijeni pagesat per uniforma eshte duke u bere nga prindit, dhe kisha dashtë me dite se nses ndonjë nxens nuk i ka mundësit qe te beje kete pagese te uniformes a keni parapat qe ti ndimohet këtyre familjeve.

z.Ruzhdi Shehu, e kemi parapare edhe këte qeshtje, e kemi edhe donatorin, ndërsa sa i perkete psikologes, akomodimi i saje ne shkole nuk eshte bere akoma ashtu siq kërkohen kushtet e punës se saje dhe per momenti funksionon me orare te përgjysmuar, jemi ka shikojmë mundësin qe kjo qeshtje te jete fnksionale ashtu siq kërkohet.

z.Shpejtim Gacaferi, kerkese tjetër nuk ka e shpalli te përfunduar mbledhjen e pare per vitin 2024.

Procesmbajtësi:

z. Esat Hoxha

Kryesuesi i Kuvendit:

z. Shpejtim Gacaferi



REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNIK

Vendi: Komuna e Junikut
Hartuesi: Komiteti për Komunitete
Lloji i punës: Raport pune

RAPORTI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2023

Junik, shkurt 2023

Komiteti për Komunitete me qëllim të realizimit të detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e Punës së Komiteteve të Komunës së Junikut dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale për vitin 2023 harton këtë:

RAPORT P U N E

Hyrje:

Komiteti për Komunitete është organ i formuar nga Kuvendi i Komunës së Junikut në harmoni me Statutin e Komunës së Junikut dhe Rregullores së punës së Kuvendit.

Misioni:

Siç është përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Komiteti për Komunitete është përgjegjës për të trajtuar çfarëdo çështje që ka të bëjë me diskriminimin e një personi mbi çfarëdo baze siç është: gjuha, religjioni, prejardhja etnike, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me interesin e një komuniteti.

Komiteti për Komunitete numëron gjithsej 5 anëtarë prej të cilëve 3 janë femra dhe 2 meshkuj, në komitet është një përfaqësues i subjektit politik LDK, një përfaqësues i subjektit politik AAK, një përfaqësues i subjektit politik LVV, një përfaqësues i komunitetit të biznesit dhe një përfaqësues i OJQ -ve.

Gjatë vitit 2023 Komiteti për Komunitete ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje të rregullta.

Pothuajse në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar fryma e arsyes dhe janë trajtuar çështje të rëndësishme për komunitetet e Junikut.

Muaji:	Numri i mbledhjeve:	Aktivitetet:
Shkurt	Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Raporti i punës për vitin 2022. 3. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës për vitin 2023. 4. Hartimi i orarit për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të KK. 5. Informatë rreth qështjeve dhe kërkesave të komunitetit. 6. Të ndryshme.
Mars	Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Projektet për infrastrukturën në lagje dhe fshatra në komunitete gjatë vitit 2023. 3. Siguria e nxënësve të SH.F.M.U. dhe SH. M. të Lartë. 4. Të ndryshme.
Prill	Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë mbi numrin e rasteve sociale pran KK. Junik. 3. Informatë rreth aktiviteteve mujore për qështje dhe kërkesa të Komitetit në lagje dhe fshatra. 4. Të ndryshme.

Maj	Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth ruajtjes së pyjeve dhe mbrojtja e ambientit në bjeshkët e Komunës së Junikut. 3. Të ndryshme.
Qershor	Mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Shqyrtimi dhe aprovimi i raportit të punës së Komitetit për Komunitete për periudhën Shkurt – Qershor 2023. 3. Rexhistrimi i nxënësve në shk. Fillore dhe të Mesme për vitin shkollor 2023 – 2024. 4. Të ndryshme.
Korrik	Mbledhja e gjashtë e rregullt e Komitetit për Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth suksesit të nxënësve në shkollën fillore dhe të mesme . 3. Rregullorja e tatimit në pronë dhe ndihma e KK. 4. Të ndryshme.
Shtator	Mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2. Informatë rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2023-2024. 3. Zyra për komunitete të informojë rreth aktiviteteve mujore të zyrës për kërkesat e komuniteteve. 4. Të ndryshme.
Tetor	Mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2 Informatë lidhur me implementimin e projekteve të planifikuara për infrastrukturë në vendbanimet dhe lagjet e komunitetit për vitin 2023. 3 Të ndryshme.
Nëntor	Mbledhja e nëntë e rregullt e Komitetit Komunitete	<ol style="list-style-type: none"> 1 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. 2 Informatë rreth planit për mirëmbajtjen e

		<p>rrugëve lokale në Komunën e Junikut.</p> <p>3 Realizimi I planit për mbjellje vjeshtore.</p> <p>4 Shqyrtimi ose analiza dhe aprovimi I raportit vjetor të punës për vitin 2023.</p> <p>5 Të ndryshme.</p>
Dhjetor	Mbledhja e dhjetë e rregullt e Komitetit Komunitete	<p>1 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.</p> <p>2 Aprovimi I planit të punës për vitin 2024 si dhe hartimi I kalendarit për mbajtjen e mbledhjeve në vitin 2024.</p> <p>3 Të ndryshme.</p>

Komiteti për Komunitete:

Zejnepe Gaxherri _____

Kryesuese